

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Veprimtaritë e lëndës së drurit ID 7.10/b “Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit”.

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)



SUBJEKTI: “PISHA ” Sh.p.k. NIPT: K12526207V


ADRESA: Elbasan, Njësia Administrative Labinot Fushë, Fshati Labinot Fushë, Rruga Labinot Fushë-Elbasan, km 1, Zona Kadastrale 2355, pasuria”H”, ndërtesa nr.1



Profili subjektit

Subjekti "PISHA Sh.p.k është e regjistruar ne organet tatimore me nr identifikimi NIPT: K12526207V, me vendndodhje Elbasan, Njesia Administrative Labinot Fushe, Fshati Labinot Fushe, Rruga Labinot Fushe-Elbasan, km 1, Zona Kadastrale 2355, pasuria"H", ndertesa nr.1

Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4



pikat	X	Y
1	4556878.29	4428590.71
2	4556954.86	4428673.00
3	4556938.06	4428691.65
4	4556858.41	4428608.18
5	4556867.72	4428568.61

PLANVENDOSJA E PRONES DHE OBJEKTIT

Qellimi i projektit

Subjekti "PISHA Sh.p.k do te aplikojë për leje mjedisore të tipit B për aktivitetin Veprimtari të lëndës së drurit. Klasifikimi bazuar në ligjin 10448 Veprimtari të lëndës së drurit ID7/10.b Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj shtojcë Prodhimi i produkteve të perbera teresisht nga druri nëq veprimtaria përfshin: Sharrimin, shpimin, ferkimin me rere, gdhendjen, tornimin, zdruktimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.

Objektivat e aktivitetit

Objektivi i parë i këtij aktiviteti do të jetë të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore të këtij instalime të cilat janë:

- Emetimet në ajër dhe zhurmat
- Ndikimi në flore/faunë
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim në cilësinë e jetës në qendrat e banuara
- Ndikim në rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim në peizazhin e zonës


Objektivi i dytë i këtij aktiviteti është gjetja e alternativave që janë më miqësore me mjedisin.

Proçesi teknologjik i përpunimit të drurit

Lenda e parë sigurohet nga subjekti nëpërmjet parcelave që ka marrë për shfrytëzim në zonën e Librazhdit si dhe nga importi .

- Sipërfaqja e përgjithshme ku ushtrohet veprimtaria 2830 m²
- Sipërfaqja e ndërtesës 305 m²

Planimetria e katit përdhe ku ushtrohet aktiviteti



Proçesi teknologjik është i thjeshtë. Për zhvillimin e aktivitetit ka rëndësi sigurimi i lëndës së parë që sigurohet nga parcelat drusore që ka vetë subjekti dhe një pjesë merret nga importi. Transportimi i lëndës

drusore nga parcela deri ne vendin e punes behet nga subjekti dhe depozitohet ne sheshin e lendes se pare ku fillon dhe proçesi. Trungjet e drurit i nenshtrohen proçesit te prerjes. Prerja e materialit drusor behet ne gader (ku behet prerja per se gjati) dhe pastaj kalohet ne pendul ku prodhohet derrasa sipas permasave, behet sistemimi i tyre per tharje natyrale te cilat me qellim qe te jene te gatshme per treg ne baze te kerkesave. Subjekti perdor metoden e tharjes natyrale per derrasen.

Pasi prodhohet lenda e prere fillojne proçedurat e perpunimit te lendes drusore (derrases) ne repartin e prodhimit ku hyn ne multidisk i cili ben prerjen ne elemente drurit sipas dimensioneve qe duhet dhe pas saj materialet dergohen ne repartin e prodhimit ku ambalazhohen sipas kerkesave sipas kerkesave qe ka subjekti nga te tretet).

Ne fund behet shperndarja e produkteve te prodhuara qe ne rastin konkret jane derrasat dhe elementet e drurit.

Mbetjet teknologjike qe dalin nga proceset e perpunimit te drurit qe jane tallashi, copat e vogla, levoret etj grumbullohen dhe jane lende e pare per prodhimin e peletave.

Paisjet baze te ketij aktiviteti jane: Gadra, sharra shirit 3 cope, prese druri 3 cope, prese hidraulike per prerje druri 4 cope, pirun cope 2 makine me vinc cope 1

Proçesi teknologjik i prodhimit te pelletave

Krahas prodhimit të lëndës drusore subjekti ka instaluar dhe linjën e prodhimit të pelletave aq shumë të kërkuara në industrinë energjitike si edhe për përdorimin individual të popullates për ngrohje, gatim etj.

Pra subjekti perpunon lende drusore te klasifikuara si mbetje teknologjike, per prodhimin e pelletave, te cilat perdoren gjereisht si lende djegese .


Operacionet kryesore në fabrikë për prodhimin e pelletëve janë si më poshtë:

- GRIRJE;
- THARJE;
- NDARJA MAGNETIKE;
- RAFINIMI;
- PËRZIERJEN DHE NGARKIMIN E MAKINERISË;
- BERJA PELLET;
- FTOHJE, HEQJA E PLUHURIT;
- PAKETIMIN;

Proçeset teknologjike te perpunimit te lendeve te ndryshme drusore, si coptimi, tharja , presimi, transportimi dhe ambalazhimi, shoqerohen me prani apo gjenerim te grimcave te imta te kesaj lende (tallazh) me peshe relativisht te lehte. Per te minimizuar apo eliminuar daljen e tallazhit, nga pjeset teknologjike ku zhvillohen keto proçese, eshte kryer instalimi i nje sistemi aspirimi dhe pluhur-kapje. Pajisja kryesore e ketij sistemi eshte pluhur-kapesi me munge, nje pjese me rendiment te larte deri ne 99%, ne kapjen e pluhurave te kesaj natyre. Te gjithë pluhurat e tallashit te kapur ketu, rikthehen ne proçesin e formimit te pelletave.

Kjo zgjidhje teknologjike, zvogelon ndjeshem humbjet fizike te lendes se pare dhe njekohesisht zvogelon apo eliminon efektet negative ne mjediset e vendeve te punes dhe me gjere, nga prania e grimcave te tallazhit.

Pajisjet e instaluara ne kete linje teknologjike jane te lidhura ne menyre teknike me njera – tjetren, duke patur nje sistem kontrolli dhe komandimi unik. Ato punojne ne menyre te sinkronizuar ne raport me sasine e lendes qe trajtojne, parametrat teknologjik qe duhet te realizojne etj. Çdo difekt apo anomali e shfaqur ne njerren prej tyre reflekton ne nderprerjen e punes ne te gjithe linjen apo ne prishjen e treguesve cilesor te prodhimit. Kjo linje ka kapacitet prodhues prej deri ne 800-1100kg/ore.



Proçesi i Prodhimit:

Proçesi i prodhimit të pelletit përfshin vendosjen e biomasës nën presion të lartë duke e detyruar atë nëpërmjet një instalimi që kryen procesin e rumbullakimit të quajtur "Die." Kur e ekspozuar ndaj kushteve të përshtatshme, biomasa "ne forme kapsolle" të cilat formojnë një masë të fortë. Ky proces është i njohur si "ekstrudim." Disa biomasa (kryesisht lende prej druri) natyrisht formon pelletin në formë kapsolle me cilësi të lartë, ndërsa llojet e tjera të biomasës mund të kenë nevojë për aditivë të shërbejë si një "kordon" që mban toptë së bashku. Megjithatë, krijimi i fishekëve të pelletit është vetëm një hap i vogël në procesin e përgjithshëm të prodhimit të pelletit. Këto hapa përfshijnë proceset si bluarje (gritja e lendes drusore, apo lendeve të tjera që përdoren si kartoni, letra, tallashi, etj si lende e quajtur biomase), kontroll të lagështisë, ekstrudim, ftohje, dhe paketimit. Çdo hap duhet të bëhet me kujdes nëse produkti final është që të jetë me cilësi të pranueshme konform kërkesave që përcaktohen nga bleresi.

Grirja:

Është procesi i zvogelimit në copeza të dimensioneve të vogla prej material druri që mund të jenë në forma të ndryshme.

Përdoren material si:

- ❖ Trungu dhe degë të dimensioneve të mëdhaja
- ❖ Degë të vogla, barishte dhe mbetje druri
- ❖ Tallash si mbetje i sharrave dhe mobilerive
- ❖ Dru i ardhur nga kultivim energjie

Për materialet e sipërpermendura është e nevojshme të bëhet një copëzim paraprak, nëpërmjet procesit të grirjes.

Tharja.

Është procesi i reduktimit të përmbajtjes së lagështisë i pranishëm në materialin drusorë që do të pelletizohet. Lenda e pare sic kemi përmendur më lart janë Copa druri con me dimensione (20x20x3mm), tallash dhe ashkla të thata nga druri .

Megjithatë për të prodhuar pellet tharja duhet të kryhet deri në arritjen e një përqindje të përmbajtjes përfundimtare lagështisë në mes të 8% dhe 12% por e pranueshme është dhe 9-14%.

Proçesi i tharjes ndodh në brendësi të një tharëse rrotulluese me furnizimin e copëza druri në mënyrë të vazhdueshme, ku produkti i nënshtrohet një nxehtësi të fortë të prodhuar duke përdorur ajrit të nxehtë të gjeneruar nga një –kaldajë e grupit pyrolyzer, që frynë ajër të nxehtë brenda tharëse. "Grupi Novapellet - kaldaja, furnizohet me copëza druri nga mbeturinat e prodhimit"

Rafinimi (sitimi)

Proçesi i rafinimit të copëzave të drurit bëhet nëpërmjet kalimit të produktit në një mulli rafinues që shërben për të zvogëluar madhësinë e të gjithë llojeve të drurit. I pajisur me çekiç rrotullues dërgon materialin drejt thikave duke i copëtuar. Pjesa e poshtme e makinerisë grirëse është e pajisur me një rrjet kalibrimi e pozicionuar në një distancë të duhur nga boshti rrotullues. Rrjeta e tillë lëshon vetëm materialin me permasat e dëshiruara .

Përzierja dhe furnizimi i makinerisë

Tërë materiali që ka kaluar sitën transportohet në mënyrë të ngadaltë në majë të përziersit ku spiralet të përshtatshëm të montuara në të njëjtin aks shtyjnë materialin drejt majës, në atë që mund të quhet koka e transportuesit.

Përzierja e komponentëve të ndryshëm është bërë gjatë transportit në rritje si dhe në bazën e mikser gjatë akumulimit .

Nga baza e mikser, me anë të një “kërmilli”, materiali transportohet për shtypjen (ngjeshjen).

Proçesi i bërjes së pelletit

Proçesi i bërjes së pelletit kryhet me anë të një shtypëse (ngjeshjeje) rrotulluese; materiali i rafinuar pa ngjites të shtuar, futet në një centrifugë me bazë të shpuar me brima që rrotullohet në një shpejtësi prej rreth 150 rpm, ku kjo e ngjesh materialin e situar të drurit për t'u bërë pellet. Të pozicionuar brenda centrifugës janë disa rrulla presioni që ngjeshin materialin brenda brimave të bazës, me anë të disa thikave kryhet prerja e pelletit me gjatësinë e kërkuar

Ftohje, heqja e pluhurit;

Pelleti i sapoprodhuar nga presa del me një temperaturë rreth 50⁰C dhe nëpërmjet një transportuesi dërgohet në një silloz vertikal , me anë të një aspirator ajri krijohet një ventilim vertikal me anë të të cilit ftohet materiali dhe pastrohet nga pluhurat, duke bërë produktin e qëndrueshëm dhe duke përmirësuar cilësinë përfundimtare. Tharësi eliminon lagështinë e shtuar nga proçesi i nxehtësisë së shtuar nga motorri i ngjeshjes.

Pelleti që është ftohur transportohet gjithmonë nga rrip transportues në një silloz magazinimit të gatshëm për tu paketuar.

Paketimi

Pelleti që është transferuar nga rripi transportues nga silloset e magazinimit deri në makinerinë gjysmë-automatike që bën paketimin dhe peshimin të pelletit në qese ose me thasë të mëdhej industriale gati për tu tregëtuar.

- **Të dhëna mbi impiantin e instaluar**

Pjese e pershkrimit te proçeseve te prodhimit te pelletes, eshte edhe skema teknologjike ne vijim, ne te cilen jane paraqitur makinerite dhe pajisjet e instaluara si dhe lidhja e tyre teknologjike, nga perpunimi i lendes se pare deri ne realizimin e produktit te gatshem per treg.

Ne te pershkruen zonat ne vijim:

- Zona 1- grireset e mbetjeve drusore
- Zona 2- heqja e lageshtise siperfaqesore ose tharje e lendes se pare
- Zona 3- pajisjet e kapjes se pluhurave, qe dalin gjate tharjes
- Zona 4- pajisjet kryesore te kapjes se pluhurave
- Zona 5-pajisjet e presimit dhe te formimit te pelletave
- Zona 6-pajisjet e ambalazhimit te prodhimit te realizuar

Ne kete linje teknologjike me nje kapacitet prej rreth 1 ton/ore prodhim pelleti, lenda e pare qe perdoret jane materialet drusore dhe mbetjet drusore, si:

- Tallashi e copa druri qe dalin gjate proçeseve te prodhimit te mobiljeve, dyreve e dritareve, karrigeve, etj.
- Dege e levore te pemeve gjate shfrytezimit te parcelave pyjore si dhe gjate perpunimit te trungjeve per nxjertjen e derrases.
- Mbetje te kopshteve e parqeve private e publike, kryesisht dege pemesh e gjethesh
- Levozhga te arrave, bajameve, lajthive, garat e ullinjeve e te frutave te ndryshme etj, nga linja e prodhimeve ushqimore.

E gjithë kjo sasi lende e pare, kalon ne proçesin e grirjes apo te coptimit, duke krijuar nje perzjerje fizike te llojeve perberes, ne madhesi grimcash pa a shume uniforme. Pajisje grirese me çekica e prodhimit itjaljan, ka nje kapacitet perpunues rreth 20 m³/dite.

Duke analizuar permbajtjen e lageshtise siperfaqesore te lendes se pare te pergatitur (permbajtja optimale e lageshtise eshte 8 – 12 %, percakton parametrat teknologjike te tharesit, sic jane:

- Temperatura e zones se djegies se lendes djegese pra, e zones se tharjes
- Sasia e materialit qe do kaloje ne thares

Kjo pajisje perdor si lende djegese nje sasi perj rreth 200 kg/ore, tallash druri ose pellete te prodhuar nga vete shoqeria.

Produktet e djegies duke levizur pergjate pajisjes tharese, mbartin me vete grimca te imta te lendes qe kalon ne kete proces. Per kapjen e tyre, ne dalje te pajisjes tharese eshte instaluar nje bateri ciklonesh, te cilet bejne te mundur kapjen e grimcave te ngurta dhe pastrimin e gazeve qe shkarkohen ne atmosfere.

Grimcat e ngurta rikthehen ne proçesin e prodhimit te pelletes duke u bashkuar me produktin e thare dhe duke kaluar ne procesin e formimit te pelletes.

Jane instaluar disa pajisje formuese te pelletes, pari i punes te te cilave eshte formimi nen efektin e ngjeshjes se materialit te coptuar e te thare, pa perdorur lende apo substanca ngjitese. Pelleti formohet/lidhet nga kohezioni i siperfaqeve te kokrrizave brenda tij, nga pjeset fibrore te grimcave dhe kryesisht nga adezioni i shkaktuar nga linja qe eshte zbutur nga nxehetesia qe mbartin me vete keto lende si dhe ajo qe krijohet gjate ngjeshjes se tyre. Pelletat e formuara ne forme cilindrike apo sferike kane permasa 6-12 mm.

Pelletat e formuara kalojne me pas ne pajisjet e ambalazhimit te tyre. Keto pajisje perbehen nga keto pjese:

- Mbajtesen e thesit plastik apo prej letre
- Dozatorin

- Peshoren
- Pajisjen e mbylljes/qepjes se thesit te mbushur

Shkarkime ne ajer - Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi shkarkime, por mund te kemi çlirime te lehta nga mjetet te cilat vijne per tu furnizuar. Komponente te çliruar mund te citojme CO, NO₂, SO₂. Zona ne fjale eshte zone urbane shume e frekuentuar. Keshtu qe gjenerimi i gazeve nga mjetet do te jete Relacion Joteknik 3 ne intervale te shkurtra kohe dhe mund te konsiderohet i paperfillshem. Duhet te theksojme edhe faktin se mjetet gjate furnizimit me lende djegese fiken.

Shkarkime ne ujra- aktiviteti nuk perdor uje per nevoja teknologjike me perjashtim te ujrave per nevoja sanitare. Ujrat e nyjeve sanitare se bashku me ujrat siperfasore qe vijne si rezultat i reshjneve te shiut do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

Shkarkime ne toke- Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do te kete shkarkime ne toke, mbetjet te cilat do te gjenerohen si pasoje e aktivitetit do te grumbullohen dhe do te depozitohen fillimisht ne nje shesh te shtruar me beton ku do te evadohen per prodhimin e pelletave. Per kete subjekti ka lidhur kontrate me subject te licensuar qe prodhon pelletat. Mbetjet ditore si plastika, letar etj qe krijohen nga punonjesit do te futen ne konteniera te mbyllura ne ambientet e aktivitetit dhe ne fund te cdo dite pune do te largohen per ne vendet e perbashkta te administruara nga Pushteti Vendor,.

Gjenerimi i zhurmave- Brenda aktivitetit ka zhurma per efekt te pune se paisjeve si eshte gadra, makinat e prerjes se drurit dhe makina te tjera por duke qene se aktiviteti zhvillohet larg zonave te banuara keto zhurma ne mjediset e jashtme jane te paperfillshme.

Pra proceset e prodhimit shoqerohen me çlirim zhurme, por nuk vleresohen ne nivele shqetesuese per zonen, vetem per ambientet e punes. Per kete operatori eshte kujdesur qe punonjesve t'u siguroje veshje mbrojtese. Zhvillimi i aktivitetit mund te ndikojte ne nje rritje shume te lehte te zhurmes per mos thene qe do jete e paperfillshme

- Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes

Vendi i zhvillimit te aktivitetit disponon te gjithe kapacitetin dhe hapësiren per te operuar pa krijuar ndotje dhe shqetesime, gjithashtu theksojme se ne po te njejtin vend subjekti ka operuar edhe me pare i paisur me Leje Mjedisit tip C sipas ligjit ne fuqi.

- Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis

Shkarkimet qe vijne si pasoje e zhvillimit te aktivitetit nuk mund te konsiderohen ndotese. Keto shkarkime do te jene normale, brenda legjislacionit aktual ne fuqi. Operatori do te marre masa te vazhdueshme per minimizimin sa me te madh te tyre, duke bere edhe monitorimet perkatese per komponentet e cituar ne Anekset e mesiperme. Çlirime te lehta ne ajer do te konsiderojme gazet CO, NO₂, SO₂, te cilat nga aktiviteti nuk gjenerohen ose mund te themi mund te kete vetem ne momente shume te shkurtra kohore vetem ne momentin e ndezjes se motorrit te mjetit qe transporton bazen materiale ose qe bie bazen materiale konkretisht lenden drusore).

Ndikimet negative ne mjedis	
Rrezatimi Jonizues	
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese	
Vibracionet	

<p>Funksionimi i aktivitetit gjeneron vibrime shume te lehta vetem ne rastet kur autobotet transportojne lendet djegese, e cila ndodh vetem ne harqe kohore te shkurtra, gjithashtu edhe ne momentin kur furnizohen mjete te renda. Keto vibrime jane shume te lehta, nuk ndikojne negativisht ne mjedisin e zones, shqetesimin e banoreve apo bizneseve qe ndodhen ne afersi te aktivitetit.</p>
<p>Ndikimet ne popullsi</p>
<p>Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku zhvillohet aktiviteti. Gjate funksionimit te aktivitetit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambjentin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsisë se rajonit</p>
<p>Ndikimet ne toke</p>
<p>Aktiviteti nuk gjeneron shkarkime ne toke.</p>
<p>Mbetjet e ngurta</p>
<p>Mbetjet e ngurta qe dalin si rezultat i aktivitetit do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per pelletizim pra do te riperdoren, ndersa mbetjet urbane do te evadohen ne vendet e caktuara nga Pushteti Vendor. Kompania do te punoje per ndarjen e tyre qe ne vendburim, nepermjet konteniereve me ngjyra.</p>
<p>Ndikimet ne ajer</p>
<p>Referuar natyres se aktivitetit nuk mund te kemi ndikime negative ne ajer. Clirime minimale ne ajer, mund te kemi vetem ne momentin e ndezjes se mjeteve qe shkarkojne dhe ngarkojne lenden e drurit , megjithate ne pikepamjen mjedisore dhe shendetesore keto ndikime mund te konsiderohen te paperfillshme.</p>
<p>Ndikimet ne ujera</p>
<p>Funksionimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne ujera. Ne ujera do te kemi vetem shkarkimin nga nyjet sanitare dhe ujrart e reshjeve te shiut te cilat do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.</p>
<p>Ndikimet ne klime</p>
<p>Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone</p>
<p>Ndikimet ne floren dhe faunen</p>
<p>Zona në te cilen ushtrohet aktiviteti është një zonë urbane dhe nuk mund te analizojme ndikime ne flore dhe faune. Operatori do te shtoje siperfaqet e gjelberta per nje pamje vizuale me te kenaqshme per syrin dhe per te mirat ne pikepamjen mjedisore.</p>
<p>Ndikimet nga zhurmat</p>
<p>Zona ne te cilen zhvillohet aktiviteti eshte nje zone rurale por ne afersi te tij zhvillohen dhe disa aktivitete te tjera. Zhurma eshte prezente ne rastin kur prehet dru ne mjediset e jashtme. Nga qarkullimi i makinave nuk ka ndikim sepse eshte larg aksin nacional . Funksionimi I aktivitetit nuk pritet te kete rritje te nivelit te zhurmave, aq me teper ndikime negative ne kete prizem.</p>
<p>Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin</p>
<p>Aktiviteti që ushtron shoqeria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së ciles dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashëgimime arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar kete aktivitet.</p>
<p>Ndikime ne rrjetin hidrografik</p>
<p>Natyrë e aktivitetit nuk kerkon perdorim te ujit. Perdorimi i ujit qe do perdoret per nyjet sanitare do te kryhet nga rrjeti publik dhe do te shkarkohet ne rrjetin e kanalizimeve te zones.</p>
<p>Ndikimi social-ekonomik</p>
<p>Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit, ne aspektin e punesimit.</p>

Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme

1. Teknikat më të mira të disponueshme " (TMD) do të thotë faza më efektive dhe e avancuar në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodat e tyre te veprimit të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar në parim bazat për vlerat limite të emetimeve të percaktuara për të parandaluar dhe ku nuk është e praktikueshme, në përgjithësi për të reduktuar emetimet dhe ndikimin i tyre në mjedis në tërësi:

2. 'Teknika' përfshin te dyja si teknologjine e përdorur dhe mënyren në të cilën impianti është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe çmontuar.

3. Teknikat me te mira te disponueshme' do të thotë ato qe jane te zhvilluara në një shkallë që lejon zbatimin në sektorin përkatës industrial, nën kushte ekonomikisht dhe teknikisht te zbatueshme, duke marrë parasysh kostot dhe përparësitë, nëse janë apo nuk janë përdorur ose prodhuar teknikat brenda territorit të Pales në fjalë, për aq kohë sa ato janë mjaft te lejueshme per operatorin;

4. Me të mirë ' do të thotë më efektiv në arritjen e një niveli të përgjithshëm të lartë të mbrojtjes së mjedisit në tërësi. Në përcaktimin e teknikave më të mira të disponueshme, konsideratë të veçantë duhet t'i jepet, në përgjithësi, ose në raste të veçanta faktorëve të mëposhtëm, duke pasur parasysh kostot me të mundshme dhe përfitimet nga një masë dhe parimet e masës paraprake dhe parandalimit:

5. Proceset e krahasueshme, pajisjet apo metodat e funksionimit të cilat kanë qenë provuar me sukses në një shkallë industriale;

6. Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuri shkencore dhe të të kuptuarit;

7. Natyra, efektet dhe vëllimi i emetimeve në fjalë;

8. Datat e montimeve për instalimet e reja apo ekzistuese;

9. Koha e nevojshme për të futur teknikën më të mirë të mundshme;

10. Konsumi dhe natyra e lëndëve (përfshirë ujin) të përdorura në proces dhe efikasitetin e saj të energjisë;

11. Nevoja për të parandaluar apo zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emetimeve në mjedis dhe rreziqet për të;

12. Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin. Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit të ndonjë teknike ose teknologjie të veçantë, por marrjes parasysh të karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore

- Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur

Aktivitetit është ekzistues dhe që ne fillim ka qenë ne te njejten vendndodhje, kjo sepse është ne nje zone shume te frekuentuar e cila sa vjen dhe zhvillohet me shume. Per kete arsye edhe fitimet ekonomike arrijne targetin qe kompania i ka vendosur vetes. Teknologjia është bashkohore dhe kërkesat për këto lende është e larte, duke rritur fluksin e punes.

- Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme)

1. Grumbullimi i mbetjeve teknologjike ne sheshin e percaktuar per to dhe evadimi i tyre per riperdorim per pelleta
2. Mbetjet urbane ne konteniere te posacem dhe hermetik per te evituar aromat e pakendshme sidomos ne periudhe reshjesh dhe thatesire.
3. Diferencimi i mbetjeve te ardhura nga aktiviteti i punonjesve qe ne burim ne kosha me ngjyra.
4. Depozitimi periodik ne vendet e perbashketa qe administrohen dhe terhiqen nga Njesia e Qeverisjes Vendore.
5. Mbajtja e regjistrave per sasine e mbetjeve te gjeneruara dhe depozitimi i tyre ne harqe kohore 6-mujore ne instancat shteterore perkatese.

MBETJE QË DALIN NGA PËRPUNIMI I DRURIT DHE PRODHIMI I PANELEVE DHE MOBILJEVE, BRUMIT TË LETRËS, LETRËS DHE KARTONIT

- 03 01 01 Mbetje të lëvres dhe të tapës
- 03 01 05 Pluhur sharre, ashklat, copa prej druri, panele me materiale grimcore dhe me pllaka, të tjera nga ato të përmendura në 03 01 04
- 03 03 01 Mbetje të lëvoreve dhe drurit
- 03 01 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 03 02 Mbetje të produkteve që përdoren në staxhionimin e drurëve

- Masat për përdorimin eficient të energjisë

1. Auditimi vjetor, nga auditues ne proçese per evidentimin e perdorimit eficient te energjise.
2. Kualidimi i vazhduar i paisjeve.
3. Vleresimi nga menaxheri i energjise per gjendjen e paisjeve dhe vleresimit i pjeseve me te reja.
4. Vendosja apo zevendesimi i pajisjeve jo me vone se 2 vjet pas perfundimeve te dala nga Audituesi i Energjise.

Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre

Detyrat e punedhënesit

- Punëdhënësi vetë ose personi përgjegjës që ka ngarkuar, duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:
- Specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet që do të perdoren.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.

- Veçoritë e punës, ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmatur aksidentet dhe ruajtur shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Përveç sa më sipër punëdhënësi ka detyrë që:

- Të sigurojë për çdo rast ndihmen e parë mjeksore.

- Të vendos në territorin e instalimit, në vende të dukshme tabelat me rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.

- Të bëjë instruktimin periodik të punonjësve dhe të plotësoj për këtë qëllim formularët bazë të përcaktuar në rregulloret e sigurimit teknik.

Detyrimet e punëmarrësit

- Të njoh mirë procesin e punës dhe makinerit apo pajisjet që ka në përdorim.

- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.

- Të mbrojë veten dhe shokët gjatë punës.

- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masa duhen marrë për shmangien e rrezikut.

- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë

Janë ndërmarre masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme

Natyra e nje aktiviteti te tille nuk preket nga nderprerje sezonale. Per kete arsye nderprerjet definitive do te shoqerohen me zbatimin e planit te çmontimit te instalimit dhe zbatimin e plote te planit te rehabilitimit te mjedisit postfuzionim. Gjithashtu per nderprerje te tilla si pasoje e avarive qe shoqerohen me ndotje te tipeve te ndryshme duhet te njoftohen instancat shtetore. Megjithate aktivitetit nuk parashikon nderpreje apo mbyllje te aktivitetit.

- Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Qëllimet e monitorimit mjedisor Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë. Eshhtë që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.

- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.

- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar linja e prodhimit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga faktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar

Program i monitorimit

Parametrat	Shpeshtesia e raportimit	Pikat e matjes
Monitorimi i shkarkimeve ne atmosfere LNG, PM10, CO, SO ₂ , NO ₂ (kur punohet));	Çdo 6 muaj ne se do te punohet	Sipas koordinatave perkatese
Monitorimi i shkarkimeve te ujit siperfasor dhe sanitar ne kanalizime	Çdo 6 muaj	Sipas pikes se percaktuar
mbetjet	Çdo 6 muaj	plotesimi i formulareve perkates
Ankesa ne se ka		

